



Qendra Kombëtare e Biznesit

Raport vjetor

2024

Shkurt 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS
DHE INOVACIONIT

Emërtime të shkurtuara

QKB – Qendra Kombëtare e Biznesit

HRMIS – Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

RT – Regjistri Tregtar

RKLLA – Regjistrin Kombëtar të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve

RPP – Regjistri i Pronarëve Përfitues

AKSHI – Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

ILDKPKI – Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

DPT – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

KLJGJ – Këshilli i Lartë Gjyqësor

KPK – Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Moneyval – Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave

Përmbajtje

1. Hyrje	4
2. Veprimtaria	6
2.1 Mbi përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga QKB	6
2.2 Mbi aplikimet e trajtuara nga strukturat përgjegjëse	8
2.3 QKB përgjatë 2024	8
2.3.1 Biznese të regjistruara sipas qarkut	10
2.3.2 Biznese të regjistruara sipas aktivitetit kryesor	11
2.3.3 Biznese të regjistruara gjatë periudhës 2019 – 2024	12
2.3.4 Madhësia totale e Regjistrit deri në fund të vitit 2024	13
2.3.5 Numri i aplikimeve në Regjistrin Tregtar	14
2.3.6 Biznese me të paktën një ortak të huaj nga vendet e rajonit të regjistruara gjatë vitit 2024	15
3. Mbi kuadrin ligjor dhe iniciativat ligjore	16
4. Integrimi në BE	17
5. Aktivitete	17
5.1 Pjesëmarrja në takimet e CEFTA	17
5.2 Certifikimi me Standardin ISO 9001:2015	17
5.3 Pjesëmarrje në European Business Registry Association	18
5.4 Plani Kombëtar OGP 2022-2024	18
5.5 Strategjia kombëtare për parandalimin e pastrimin të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2027.	18

1. Hyrje

Ky raport siguron informacion mbi popullimin e Regjistrit Tregtar, Regjistrin të Leje/Licencave dhe Autorizimeve dhe Regjistrin të Pronarëve Përfitues në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

QKB ushtron këto funksione

- mban regjistrin tregtar
 - kryen regjistrimet në regjistrin tregtar
 - publikon të dhënat e regjistruara
 - siguron aksesin e lirë të publikut
 - trajton procedurat e licencimit, të autorizimit apo të lejeve, të ndryshimit dhe revokimit të tyre
 - mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve
 - siguron aksesin e lirë të publikut në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve
 - informon dhe këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit, si dhe procedurat e licencimit, autorizimit e lejimit
- administron Regjistrin e Pronarëve Përfitues dhe ka përgjegjësi të regjistrojë, të administrojë, të përpunojë dhe ruajë në regjistër të dhënat e deklaruara nga subjektet raportuese.

Ligjet që zbatohen

- Ligji nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”,
- Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar
- Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 112/2020, “Për Regjistrin e Pronarit Përfitues”, i ndryshuar.

VEPRIMTARI në Regjistra



Administratore
femra

5754

Për vitin 2024 janë
regjistruar 5,754 biznese
me administratore femra.



Forma ligjore me numrin
më të lartë të regjistrimeve
është "Person Fizik" me
12,935 regjistrime.



4112

Biznese kanë
deklaruar Pronarin
Përfitues.

175 388

Ndërveprime në
Regjistrë

1.3m

Klikime në faqen e web

www.qkb.gov.al



Aktiviteti Kryesor

Bizneset me numrin më të lartë të regjistrimeve sipas
Aktivititetit Kryesor:

27.8%	Tregtia me shumicë dhe me pakicë;
15.64%	riparimi i automjeteve dhe motorcikletave
7.79%	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor
7.66%	Shërbime administrative dhe mbështetëse
7.07%	Ndërtimi
	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike

253

Kundravajtje
administrative për
subjektet që nuk
kanë deklaruar në
kohë Pronarin
Përfitues.



Leje/Licenca të
lëshuara nga Qendra
Kombëtare e
Biznesit

2122

3 Licencat më të kërkuara

- 595 licenca për Shërbime mjeksore parësore dhe/ose stomatologjike
- 253 licenca për Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve
- 138 licenca për Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)

2. Veprimtaria

- QKB gjatë vitit 2024 ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e regjistrimit, licencimit/lejimit/autorizimit të biznesit dhe regjistrimit të pronarëve përfitues.
- Gjatë ushtrimit të kompetencave të institucionit për vitin 2024 në fokus të punës së strukturave përgjegjëse të QKB ka qenë ofrimi i të gjithë shërbimeve online nëpërmjet portalit qeveritar *e-albania*.


2.1 Mbi përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga QKB

Përmes digjitalizimit është bërë e mundur që shërbimet e QKB të jenë më të shpejta, më të lehta dhe më cilësore.

• Ndërveprimi i Regjistrat Tregtar me Sistemin Tatimor dhe institucionet e tjera

Duke filluar nga prill 2024, QKB në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitutional, konkretisht me DPT, ka mundësuar aksesin në sistemin tatimor përsa i përket verifikimit të detyrimeve tatimore në kohë reale për subjektet të cilat aplikojnë pranë QKB-së për çregjistrim të biznesit apo për pezullim të aktivitetit. Ndërkohë, në kuadër të

bashkëpunimit ndërinstitutional, QKB-ja trajton kërkesa për informacion për të dhënat e regjistruara dhe të publikuara në të tre regjistrat që administrohen nga QKB-ja, që vijnë nga Prokuroria, Gjykatat, ILDKPKI, KLGJ, KPK, Përmbarues, etj.,



· *Procesi i derregullimit*

QKB është pjesë e Grupit ndërinstitucional të punës në kuadër të reformës së derregullimit. Ky proces përfshin një rivlerësim të dokumentacionit të kërkuar dhe një analizë të kohëzgjatjes së shqyrtimit të aplikimeve. Janë përgatitur tabela e derregullimit dhe raporti analik me informacionin e nevojshëm për çdo shërbim që jepet nga QKB, duke përfshirë dokumentet që sigurohen nga nëpunësit e administratës, që do të merren nga databazat si dhe dokumentet që sigurohen nga aplikanti. Gjithashtu është dhënë informacion për afatet dhe tarifat aktuale si dhe propozimet për ndryshim.

· *Rritja e cilësisë së shërbimit nëpërmjet fushatave sensibilizuese.*

QKB ka realizuar fushata informuese dhe ndërmjetësuese për informacione mbi shërbimet

që ofrohen me qëllim rritjen e përqindjes së popullimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues. QKB ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm që përfshijnë informimin mbi të gjitha shërbimet e ofruara, mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe njoftimin e subjekteve juridike dhe organizatave joqeveritare (OJF) në lidhje me afatet për regjistrimin fillestar në regjistrin e pronarëve përfitues. Po ashtu, janë hartuar procedurat dhe standardet në përputhje me bazën ligjore në fuqi për arsyet e pezullimit/refuzimit sipas regjistrave, ndërsa subjektet juridike dhe OJF janë njoftuar për afatet për përditësimin e të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues.

Konkretisht, janë ndërmarrë këto hapa për të lehtësuar aksesin dhe përmirësuar shërbimin:

· **Hartimi dhe publikimi i kartelave informuese në platformën e-albania**

· **Njoftime të shpeshta dhe afate të qarta**

2.2 Mbi aplikimet e trajtuara

Në QKB përgjatë vitit 2024, janë kryer **175 388** aplikime në Regjistrin Tregtar, Regjistrin e Leje/Licencave dhe Autorizimeve dhe në Regjistrin e Pronarëve Përfitues nga të cilat:

Në Regjistrin Tregtar:

- **115 924** aplikime për regjistrime fillestare, ndryshime, pezullime, aktivizime, çregjistrime;
- **37 917** aplikime për dorëzim të pasqyrave financiare.

Në Regjistrin Kombëtar të Leje/Licencave dhe Autorizimeve:

- **12 726** aplikime nga të cilat **9 612** aplikime për Leje/Licence të re

Në Regjistrin e Pronarëve Përfitues:


Janë trajtuar në total **8 821** aplikime

- **8 474** aplikime për subjektet tregtare
- **346** aplikime për Organizatat jo Fitimprurese


2.3 QKB përgjatë 2024

- **248 737** biznese aktive
- **17 500** biznese të regjistruara në Regjistrin Tregtar
- **2 122** leje /Licenca të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Leje/Licencave dhe Autorizimeve
- **4 211** subjekte kanë deklaruar Pronarin Përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues

- **175 388** çështje të shqyrtuara nga regjistruesit e Qendres Kombëtare të Biznesit
- **68** Shërbime Online
- **1 342 356** klikime në faqen e web www.qkb.gov.al me rreth 2.45 faqe të para nga një visitor.



2.3.1 Biznese të regjistruara sipas qarkut



Qarqet me numrin më të lartë të regjistrimeve janë:

- Tiranë 9 158 biznese
- Durrës 1 899 biznese
- Vlorë 1 770 biznese

Qarqet me numrin më të ulët të regjistrimeve janë:


- Kukës 139 biznese
- Dibër 158 biznese
- Gjirokastrë 269 biznese

Legjenda:

- Qarqet me numrin më të lartë të regjistrimeve
- Qarqet me numrin më të ulët të regjistrimeve

2.3.2 Biznese të regjistruara sipas aktivitetit kryesor

BIZNESET SIPAS AKTIVITETIT KRYESOR



Numri më i lartë të regjistrimeve është në kategorinë “Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorcikletave” me 4 865 regjistrime ndërsa numrin më i ulët i regjistrimeve ndodhet në kategoritë “Aktivitetet të

organizatave dhe organizmave ndërkombëtare” dhe “Aktivitetet e familjeve si punëdhënës; aktivitetet të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorim të vet” me nga 1 regjistrim.

2.3.3 Biznese të regjistruara gjatë periudhës 2019 – 2024



Sipas krahasimit të bërë në periudhën 2019 – 2024, numri i regjistrimeve ka qenë më i lartë gjatë vitit 2022 me 17 899 regjistrime, ndërsa numri më i ulët i regjistrimeve ka qenë në vitin 2020.


Nga viti 2019 deri në vitin 2024 kemi një rritje prej 9.82% në numrin e regjistrimeve të bizneseve të reja.

2.3.4 Madhësia totale e Regjistrimit deri në fund të vitit 2024




2.3.5 Numri i aplikimeve në Regjistrin Tregtar


Aplikimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit



Numri i Aplikimeve në
Regjistrin e Pronarëve
Përfitues



Numri i aplikimeve në
Regjistrin Kombëtar të
Leje/Licencave dhe
Autorizimeve



Numri i aplikimeve në
Regjistrin Tregtar

Gjatë vitit 2024 numrin më të lartë të aplikimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit e mban Regjistri Tregtar me 87.7% të totalit të aplikimeve

ndjekur nga Regjistri Kombëtar i Leje/Licencave dhe Autorizimeve me 7.3% dhe Regjistri i Pronarëve Përfitues me 5%.

2.3.6 Biznese me të paktën një ortak të huaj nga vendet e rajonit të regjistruara gjatë vitit 2024



Gjatë vitit 2024 numrin më të lartë të regjistrimeve të biznesve me të paktën një ortak të huaj e ka Italia me 568 regjistrime, ndjekur nga

Kosova me 197 regjistrime dhe Maqedonia e Veriut me 33 regjistrime.

3. Mbi kuadrin ligjor dhe iniciativat ligjore

Në kuadër të procesit të riinxhinierimit, derregullimit si dhe në përrputhje me objektivat e vitit 2024 janë propozuar dhe dërguar pranë ministrive të linjës ndryshime ligjore për paketë ligjore mbi të cilën funksionon QKB.

- Ligjin Nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;

- Ligjin Nr.10081, datë 23/02/2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Ndryshime

Këto ndryshime reflektojnë realizimin e ofrimit të shërbimeve vetëm online nëpërmjet platformës e-albania, paralelisht duke rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe duke reduktuar kohën e marrjes së këtyre shërbimeve. Këto ndryshime gjithashtu kanë si qëllim zgjidhjen e problemeve të ndeshura në praktikën e zbatimit të ligjit, sigurimin e përputhshmërisë me Kodin e Procedurave Administrative dhe përmirësimin e thjeshtësimin e mëtejshëm të proceseve për të ulur kostot dhe kohën për biznesin dhe vetë QKB-në.

Vlerësime

Për këto projektligje ka përfunduar vlerësimi i Raporti i Vlerësimit të Ndikimit (RIA) dhe faza e

konsultimit publik. Aktualisht projektligjet e mësipërme janë dërguar për mendim në ministrinë e linjës. Brenda vitit 2025 pritet dhe miratimi i këtyre projektligje.

QKB gjatë vitit 2024 ka përfunduar me sukses procedurat për miratimin e projekvendimit “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.391 “Për Procedurat e Regjistrimit dhe të Publikimit”, di edhe Projekvendimit "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin 538, datë 26/05/2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” me akte e mëposhtme:

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 743, datë 04.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 391, datë 03.05.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin e Procedurave të Regjistrimit dhe të Publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 724, datë 20.11.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

4. Integrimi në BE

Gjatë vitit 2024 QKB-ja ka marrë pjesë në takimet e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës dhe takimet shpjeguese për Kapitullin 3, 6, 18, 20, 23 dhe Kriterin Ekonomik.

QKB në vijim të punës në kuadër të procesit të Integrit, ka marrë pjesë në **Takimin e 15 të Nënkomitetit**, të zhvilluar nga Komisioni European, në Bruksel, Belgjikë, më datë 30.05.2024, lidhur me “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën duke përfshirë Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shëndetit”. Raportimi u bë duke ju referuar rekomandimeve të lëna nga

Komisioni European lidhur me vitin parardhës si dhe me pyetjet konkrete të adresuara nga Komisioni European që u diskutuan gjatë takimit lidhur me ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit nr. 110/2012 “Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive Tregtare”.

Gjithashtu QKB, ka marrë pjesë në Takimin e 15 të Nënkomitetit, të zhvilluar nga Komisioni European, në Bruksel, Belgjikë, më datë 23.10.2024 - 24.10.2024, lidhur me “Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet”.

5. Aktivitete

5.1 Pjesëmarrja në takimet e CEFTA

QKB ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar me ekspertet e nënkomitetit të CEFTA-s, për "Lehtësimin e tregtisë së agjencive të udhëtimit dhe operatorëve turistikë", 16 tetor 2024, në Tiranë, lidhur me prezantimin e rezultateve dhe

analizave për ndryshimet e mundshme të legjislacionit në drejtim të harmonizimit me Vendimet e Komitetit të Përbashkët të CEFTA, të datës 9 tetor 2024.

5.2 Certifikimi me Standardin ISO 9001:2015

Në kuadër të projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, i cili zbatohet nga Qeveria Shqiptare në partneritet me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austria për Zhvillim (ADC) si kontribues kryesor, bashkë me UNDP-në dhe në zbatim të kontratës së konsulencës për “Mbështetje për Certifikimin ISO mbi Menaxhimin e Cilësisë”, QKB në vitin 2024, ka arritur të certifikohet me standardin ndërkombëtar ISO 9001:2015 për menaxhimin e

cilësisë. Pas një auditimi të realizuar nga European Quality & Safety Control, QKB ka përmbyllur të gjitha kërkesat për certifikimin e procesit të punës dhe është pajisur me këtë certifikatë më Shkurt 2024. Ky certifikim është një dëshmi e angazhimit të QKB-së për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe cilësisë së ofruar për qytetarët dhe bizneset.

**Ky certifikim shërben për të siguruar produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e subjekteve dhe ato ligjore njëkohësisht, të adresojë rreziqet dhe mundësitë, të përmirësojë performancën në përgjithësi dhe të sigurojnë një bazë të shëndosbë për nismat e zhvillimit të qëndrueshëm.*

5.3 Pjesëmarrje në European Business Registry Association

Regjistri i Pronarëve Përfitues, nëpërmjet përfaqësueve të saj ka marrë pjesë në takime të organizuara nga EBRA në formën e takimit të Grupeve të Punës, duke synuar shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira në fushën e regjistrimit të biznesit dhe pronarëve përfitues.

Në takimin e zhvilluar në Madrid, në datën 28-29 Nëntor 2024, i organizuar nga EBRA, ku u diskutua ndër të tjera lidhur me:

- Planin e veprimit të EBRA 2025
- Rishikimi i Statutit të Asociacionit të EBRA
- Platforma EBRA dhe Projekti Pilot
- Zbatimi i Strategjisë EBRA 2024-2028

5.4 Plani Kombëtar OGP 2022-2024

Shqipëria është anëtare e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (Open Government Partnership), duke ndërmarrë nisma për të promovuar hapësirën, transparencën dhe pjesëmarrjen në qeverisje. Në këtë kornizë, QKB ka angazhuar disa veprime për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të pronarëve përfitues, duke u përqëndruar në sensibilizimin e subjekteve raportuese, vlerësimin e praktikave të mira europiane dhe rishikimin e legjislacionit për të përmirësuar procedurat e regjistrimit. Këto veprime, të përcaktuara për implementim gjatë vitit 2024, janë prezantuar dhe diskutuar në një

takim online interaktiv me subjektet raportuese dhe grupet e interesit, duke siguruar një forum për shkëmbimin e mendimeve dhe sqarimeve nga përfaqësuesit e Qendrës Kombëtare të Biznesit. Gjithashtu QKB ka marrë pjesë në tryeza të rrumbullakta në Kryeministri për vijueshmërinë e zbatimit të anagazhimeve të ndërmarra, si edhe bashkëbisedimin me shoqërinë civile lidhur me shqetësimet e ngritura.

5.5 Strategjia kombëtare për parandalimin e pastrimin të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2027.

QKB ka marrë pjesë në takimet e organizuara nga Agjencia e Inteligjencës Financiare lidhur me zbatimin e masave të përcaktuara në planin e veprimit për perjudhën 2024-2027. Gjithashtu QKB ka kontribuar duke plotësuar me informacion raportime të kërkuara nga ky institucion për të evidentuar masat që QKB duhet

të përmbushte brenda vitit 2024. QKB po vijon me takime stimuluese, asistuar nga ekspert të jashtëm, me qëllim përmbushjen e masave të ndërmarra mbi punën përgatitore për raundin e 6 të vlerësimit nga Komiteti i Moneyval dhe përkatësisht për pikën IO5 që lidhet me veprimtarinë e QKB-së.

www.qkb.gov.al

Adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Numri i kontaktit: +355 4 2250066

Email: asistencaonline@qkb.gov.al

www.qkb.gov.al

**Ky është një raport i punuar duke u bazuar në paraqitjen vizuale të raportit vjetor të publikuar nga Mbretëria e Bashkuar.*